

RREGULLA PËR AUTORËT MBI DORËZIMIN E MBISHKRIMEVE NË "REVISTËN ARKEOLOGJIKE"

Revista Arkeologjike.

Revista Arkeologjike e IKTK është një botim periodik i Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

Në këtë botim do të pasqyrohen të rejat më të fundit që vijnë në arkeologjinë shqiptare në kuadër të arkeologjisë preventive të ushtruar nga vetë Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik, por jo vetëm. Kjo revistë është menduar të jetë e hapur për të gjithë operatorët, si shtetërorë ashtu edhe privat, që duan të sjellin kontributet e tyre në kuadër të arkeologjisë preventive. Kontributet që do të pranohen nuk duhet të paraqiten thjeshtë në formën e një raportimi informativ gjetjesh, por duhet të kenë karakter shkencor dhe të përmbajnë studime analitike mbi materialin arkeologjik të zbuluar.

Teksti:

Gjuha e përdorur për shkrimin e teksteve duhet të jetë shqip dhe/ose anglisht. Në rastin kur gjuha e përdorur është shqip, duhet të paraqitet edhe një përmbledhje në gjuhën angleze. Përmbledhja nuk mund të jetë më e gjatë se 3 faqe.

Tekstet duhet të paraqiten të shkruara në Word me Times New Roman, madhësia 12 dhe të jenë të ruajtura në formatin .doc apo .docx, ku hapësira mes rreshtave duhet të jetë 1 njësi. Madhësia e tekstit të titullit duhet të jetë 14.

Fjalët në gjuhë të huaj të shkruhen me shkronja të pjerrëta. Referimet në tekst nga autorë të tjerë të paraqiten në thonjëza dhe me shkrim të pjerrët.

Abstrakti:

Abstrakti mund të jetë si në gjuhën shqipe ashtu edhe angleze. Të jepen të paktën 4 fjalë kyçe për kontributin.

Referimet mbi autorët dhe rregulla mbi citimet

Shënimet në fund të faqes të jepen në numër rendor. Shënimet duhet të përmbajnë mbiemrin e autorit, vitin e botimit, numrin e faqes, figurës, skicës apo tabelës. Në rastet kur edhe për tabelat apo skicat kemi numër faqeje duhet të referohen edhe ato.

P.sh. **Bouras 1967, f. 137, Fig. 97, Tab. 12b.**

Numri i faqeve të vazhdueshme duhet të ketë një vijë në mes, ndërsa numri i faqeve të ndërprera duhet të ketë presje.

P.sh. **Hellner 2011, f. 241–242** ose **Bouras 1967, f. 137, 182, Fig. 97, 99.**

Referimet në të njëjtin shënim ndahen nga njëri tjetri me pikëpresje. Referimet me dy autorë kanë një vijë pa hapësirë në mes dy mbiemrave të autorëve. Referimet me tre ose më shumë autorë shkruhen me emrin e autorit të parë dhe me *et alii* pas ose edhe shkurtimisht *et al.*

P.sh. **Furtwängler 1906, f. 85; Hellner 2011, f. 240.**

Hoepfner-Schwander 1994, f. 114–160.

Birge et alii 1992, f. 175. apo **Birge et al. 1992, f. 175.**

Në rast se kemi më shumë botime të një autori në të njëjtin vit referimet të dallohen nga njëri tjetri me shkronja të vogla sipas alfabetit.

P.sh. **Mano 1971a = A. Mano, Nekropoli i Apollonisë – Tuma 1, Iliria 1, 1971, f. 103-201.**

Mano 1971b = A. Mano, Rezultatet e kërkimeve për zbulimin e teatrit antik të Apolonisë. Gërmime të vitit 1971, Buletin Arkeologjik, 1971, f. 94-102.

Për datimet do të citohet: **p.e.s. (para erës sonë) dhe m.e.s. (mbas erës sonë)**

Autorët antikë të citohen të plotë në shënimet në fund të faqes. Për kontributet në gjuhën shqipe, emrat e autorëve antikë të jenë të shqipëruar.

P.sh. **Straboni, Geographica, VII, 5, 8.**

emrat e autorëve antikë të lihen në gjuhën origjinale

P.sh. **Strabonis, Geographica, VII, 5, 8.**

Në literaturën e konsultuar autorët antikë do të paraqiten veçmas literaturës moderne (në fillim të literaturës).

Titujt e monografive dhe revistave të jepen me shkrim të pjerrët. Titujt e artikujve të jepen me shkrim normal.

P.sh. **R. Martín, Recherches sur l'agora greque, Paris, 1951.**

A. Mano, Nekropoli i Apollonisë – Tuma 1, Iliria 1, 1971, f. 103-201.

Veprat e mbledhura nën kujdesin e një autori të referohen sipas gjuhës së botuar: **(nën kujdesin e)** për gjuhën shqipe; **(ed., eds.)** për gjuhën angleze; **(a cura di)** për gjuhën italiane; **(éd)** për gjuhën franceze; **(Hrsg.)** për gjuhën gjermane; **(επιμ.)** për gjuhën greke etj.

Emrat e qendrave ku janë shtypur botimet të lihen në gjuhën origjinale.

Referimet për faqe do të jenë **f.**; referimet për figurë **Fig.**; referimet për tabelë **Tab.**;

Për shkurtime të periodikëve referohet lista e DAI (Deutsche Archäologische Institut), e cila përfshin një gamë të gjerë të periodikëve të botuar në fushën e studimeve arkeologjike në mbarë botën: https://www.dainst.org/documents/10180/70593/02_Abbreviations+for+Journals_quer.pdf/a82958d5-e5e9-4696-8e1b-c53b5954f52a

Imazhet:

Imazhet, tabelat, skicat duhet të jepen me përmasa 600 dpi. Ato nuk duhet të futen në tekst por të jepen në një dokument të veçantë. Imazhet duhet të kenë referimet përkatëse që do përdoren në tekst. Bashkë me artikullin do të dorëzohet lista e imazheve me të dhënat mbi to. Imazhet të përmbajnë të dhëna të mjaftueshme për të kuptuar çfarë paraqitet në to dhe të jenë të referuara në tekst. Shkrimi nën imazhe duhet të jetë i madhësisë 11.

Për çdo imazh të referohet autorësia. Për imazhet e skanuara nga botime të mëparshme të referohet autori, faqja dhe nr. i imazhit

P.sh. **Fig. ... - Selcë e Poshtme (marrë nga Ceka 1972, f. 190, Tab. XII)**

Për imazhet e marra në internet të jepet linku i saktë ku është marrë imazhi,

P.sh. **Fig. - Faltorja në veri të odeonit (marrë nga:**

<https://followinghadrianphotography.com/2016/07/13/apollonia-illyria/>)